



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

**KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, **Zizë Bujupaj**, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërrën anë;  
dhe

"CONSRUCTION GROUP" Shpk nga Prishtina, të cilën e përfaqëson, z. **Arjeta Aliti**, me Nr. Rexh. Biznesi, 810831645 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

### TITULLI I KONTRATËS:

**ASFALTIMI I RRUGËS NË LAGJËN "ZOGAJ" KALIQAN LOT 1**

<b>Nr. Prokurimit</b>	633-20/4975/ 536/ C383 – lot 1
<b>Nr. I brendshëm</b>	633 / 20 / 074 / 536

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**ASFALTIMI I RRUGËS NË LAGJËN "ZOGAJ" KALIQAN LOT**

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i kontratës për punimet **ASFALTIMI I RRUGËS NË LAGJËN "ZOGAJ" KALIQAN LOT-1** është: 6.483,00 € dhe me fjalë:

**/Gjashtëmijëekatërcindetëtdhjetëtrezeroeuro/ €**

2.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

*2.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.*

### ***Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës***

*3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:*

*Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralloqaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës*

*3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

### ***Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:***

*4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit te se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 30.11. 2020*

*4.2 Në qoftë se Kontrata nuk permbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.*

### ***Neni 5 Komunikimet***

*5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

*5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.*

*5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim,*

gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.


**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Komuna e Istogut**

**Për kontraktorin:**

**"CONSTRUCTION GROUP" Shpk**

<b>Emri:</b>	<b>Gëzim Ademaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>ARJETA ALITI</b>
<b>Pozita:</b>	<b>U.D. Menaxherit të Prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>D r e j t o r ,</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data</b>	<b>22.10.2020</b>	<b>Data</b>	<b>22.10.2020</b>
<b>V u l a:</b>		<b>V u l a</b>	

ASFALTIMI I RRUGËVE në fshati Kaliqan Lagjen Zogaj - KOMUNA E ISTOG					
III. ASFALTIMI I "RRUGËS ME GJERËSI b=3.0m" në fshati Kaliqan Lagjen Zogaj					
GJATËSIA E RRUGËS L=(m'):		120	GJERËSIA b=(m'):		3.0
		GJERËSIA E GËRMIMIT b=(m'):		4.0	
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
<b>1</b>	<b>INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN</b>				<b>156.0 €</b>
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kabllloviqe etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapësira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikycjen e instalimeve ne rrjetin te qytetit i bart operatori ekonomik.	m'	120.00	0.20 €	24.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrole te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	m'	120.00	0.10 €	12.00 €
1.3	Shenimi i trasese si dhe percjellja e punimeve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	120.00	0.10 €	12.00 €
1.4	Demolimithyerja me qekan e betoneve, ngarkimi dhe transporti i materialit deri ne deponi, dimenzionet 8mx3m	m <sup>2</sup>	30.00	2.00 €	60.00 €
1.5	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjel e drunjeve egzistues si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) dhe hapja e kanalit ne të dy anet e ruges etj.	m'	240.00	0.20 €	48.00 €
<b>2</b>	<b>PUNËT TOKËSORE</b>				<b>1,048.0 €</b>
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=25cm, dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te aferl.	m <sup>3</sup>	120.00	0.50 €	60.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se ruges në tërë gjatësin e saj me saktësi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 30-35MPa.	m <sup>2</sup>	480.00	0.10 €	48.00 €
2.3	Furnizimi, transporti dhe betonimi i dyshemes dhe mureve anesore te kanalit me beton ne trashesi mesatare d = 15cm. te klasit C-25 Armimi i pjesve te kanalit te armatures. Cmimi perfshin: Furnizimin, transportin, prerjen, lakimin dhe vendosjen e rrijetit Ø6mm - 15/15cm . Dhe punimi i griles metalike (reshetkes) me aftesi mbajtësi 15 ton. dimenzionet e kanalit 60x60x60 cm	m'	20.00	35.00 €	700.00 €
2.3	Punimi i pusestes nga betoni me dimensione 100 cm x 100cm te betohet me të gjitha elemtet percjellese konusin dhe pusefen	copë	1.00	80.00 €	80.00 €



Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
2.4	Ngjitja e pusetave te kanalizimit, punimi i kokave te tyre. Në llogari te parashihet edhe vendosja e kapakeve nga Giza me aftësi mbajtëse 15 Ton	copë	1.00	60.00 €	60.00 €
2.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave prej betoni fi 400/1000mm, 600/1000mm, 800/1000mm, 1000/1000mm sipas nevoje ne teren per punimin e lesheses. Ne kete pozicion llogariten edhe kokat hyrse dhe dalese. Vendosja e armatures rrjete Q-378 (Φ8.5/15/15) si dhe furnizimi dhe vendosja e betonit te lesheses, (pllake mbi tubacion b=1.0m dhe t=10cm) qe e trupon rrugen me beton te klases C-30/37.	m'	4.00	25.00	100.00

3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	5,279.0 €			
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilindër 25tone deri ne modulën e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	72.00	4.00 €	288.00 €
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilindër 25tone deri ne modulën e ngjeshjes 80Mpa.	m3	72.00	4.00 €	288.00 €
3.3	Matja e modulit te ngjeshmeris së trases se rruges para shtruarjes se asfaltit nga nje laborator te caktuar nga autoriteti kontraktues (menagjeri i projektit) ne vendet e caktuara poashtu nga menagjeri i projektit. Ne rast se dalin rezultatet ne kundërshtim me piken (3.2) te paramaset d.m.th. 80MPa duhet te behet perseritja e matjeve te ngjeshmerise por ne kete rast shpenzimet per rimatje i barte operatori ekonomik. Ne kete pozicion perfshihet edhe matja e trashësisë së shtresave të tamponit.	copë	1.00	50.00 €	50.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16, me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e filerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qendrueshmeris se asfaltit duhet te jete minimum 5 vjeqar prej dites kur eshte bere pranimi teknik i punimeve.	m2	405.00	8.00 €	3,240.00 €
3.5	Marja e mostrave te asfaltit per shqyrtim nga nje laborator te caktuar nga autoriteti kontraktues (menagjeri i projektit) ne vendet e caktuara poashtu nga menagjeri i projektit.	copë	1.00	50.00 €	50.00 €
3.6	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 8cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m'	120.00	2.00 €	240.00 €



Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.7	Gërmimi I dheut te kat. IV-V-(të për hapjen e themeleve nëntoksore për ndërtimin e murit mbrojtës.Dim.1.0x0.50x12m për tërë gjatësinë qe parashihet të ndërtohet.muri mbrojtës	m3	6.00	0.50 €	3.00 €
3.8	Furnizimi dhe betonimi i themeleve nen siperfaqe te tokës me dim.1.0x0.50x12m.Betonimi te bëhet me beton te armuar e duke llogaritur ne armaturen Kosh e punuar me Ø12me 12 fiye dhe stafa cdo 20cm me armaturë Ø8mm... Furnizimi dhe betonimi i murit mbrojtës me gjatësi prej 12 m, gjerësi te murit 30cm dhe lartësi L=2.2 m.Shperndarja e amaturës te jetë,Armaturë Ø12 ë futur ne themele nentoksore ne thellesi deri ne 1.0m vertikalisht sa lartësia e murit ne cdo 20cm( dy rende) e perforcuar me stafa me armaturëØ8mm ne cdo 20cm ndersa në cdo 5 m distanc te ndërtohet një kosh me Ø12 dhe stafa cdo 20-25cm me armaturë Ø8mm-per shtylla dhe po ashtu edhe ne mes te murit te vendoset një kosh me armaturë 4Ø12 te vendosur horizontalisht dhe stafa cdo 20cm me armaturë Ø8m per gjatë tërë perimetrit te murit.Ne llogari te parashihen edhe kallupet montuese dhe përkrahjet e nevojshme	m3	14.00	80.00 €	1,120.00 €
<b>III. REKAPITULIMI</b>					
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				156.0 €
2	PUNËT TOKËSORE				1,048.0 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				5,279.0 €
<b>III. TOTALI (1+2+3):</b>					<b>6,483.00 €</b>

